




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Nr. Prot.
Dep. <u>DPKI</u>	Br. Prot. <u>06-1199/20</u>
Dep.	Prot. No.
Nr. I faq.	Data
Broj stranica <u>02</u>	Datum <u>10-06-2020</u>
Nr. pages	Date
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1, nëparag. 1.5, nenit 11 paragrafi 1, nëparag. 1.1, nenit 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit, me datë 08.06.2020, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti me nr. *AKK-DPKI-06-3362/19*, për zyrtarin e lartë z. Ujkan Bajra, Drejtor i Auditimit të Brendshëm në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.
- II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë z. Ujkan Bajra, Drejtor i Auditimit të Brendshëm në Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe njëherit Kryesues i Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/L-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Lidhur me këtë, Agjencia kundër Korrupsionit e ka njoftuar zyrtarin e lartë z. Ujkan Bajra për fillimin e procedurës së shqyrtimit të rastit për konflikt të mundshëm të interesit. Pas kësaj, zyrtari i Agjencisë ka biseduar me zyrtarin e lartë lidhur me rastin e mundshëm të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve të cekura më lartë.

Agjencia kundër Korrupsionit, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës ka konstatuar se, ushtrimi i funksionit Drejtorit i Departamentit të Auditimit të Brendshëm në Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe njëkohësisht Kryesues i Këshillit Drejtues në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" nuk paraqet konflikt të interesit, mirëpo zyrtari i lartë z. Ujkan Bajra, gjatë ushtrimit të



funksionit Kryesues i Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, i nënshtrohet kufizimit të përcaktuara në nenin 13 paragrafi 2 të Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit, në të cilin shprehimisht thuhet:

“Zyrtari i lartë nuk mund të jetë anëtar i më shumë se një organi drejtues të ndërmarrjes në pronësi publike, shoqërisë aksionare me pronë publike si dhe organeve të institucioneve të tjera publike, përveç nëse parashihet ndryshe shprehimisht me ligj. Zyrtari i lartë, në cilësinë e anëtarit të organeve të përmendura në këtë paragraf, nuk ka të drejtë shpërblimi me pagesë, përveç të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve të tjera të lidhura me të”

Në ndërkohë, gjatë zhvillimit të procedurës së trajtimit të konfliktit të interesit, Agjencia kundër Korrupsionit ka pranuar edhe informacionin (DPKI-06/3362/19), lidhur me atë se z. Bajra me vendimin nr. ref. 38/01B të datës 13.05.2020 është shkarkuar nga pozita e anëtarit respektivisht kryesuesit të Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”. Nga sa u tha më lartë, u vendos si në pikën I. të dispozitivit të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 paragrafi 11, të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihapë rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

